



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

| | |
|--------------------------------|---|
| Datë/a: | 07.06.2021 |
| Referenc-ë: | 07-353/04-102760/21 |
| Për/ Za/ To: | “Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut” |
| Përmes/Preko/Through: | Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| Nga/ Od/ From: | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Pëlqim |

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 07-353/04-102760/21 nga “Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosja e dy tendave nga data 14 Qershor 2021 deri më 20 Qershor 2021 në sheshin “Nëna Terezë”

Qëllimi i kërkesës është shënimi i Ditës Botërore të dhurimit vullnetarë të gjakut andaj edhe organizohet “Java e Dhurimit Vullnetar të Gjakut”.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë” nga data 14 Qershor 2021 deri më 20 Qershor 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.